

## **RAPORT KONSTRUKTIV**

**“Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimi e Drejtorisë Forcës së Posaçme Operacionale”**

*( PROJEKT –ZBATIMI )*



| PROJEKTUES                                                                          | INXHINIER PROJEKTUES                                                                             | SUBJEKTI POROSITES                                                                    | Rev            |
|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk                                                       | Ing.Niko Naska<br>Ing. Alma Deraj<br>Ing. Ina Lila<br>Ing. Arlind Hasalami<br>Ing. Dhimiter Papa | DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT                                        | 00             |
|  |                                                                                                  | Miratuar                                                                              |                |
|                                                                                     |                                                                                                  | Nr. fq/Formati<br>56 / A4                                                             | 2020<br>Tirane |
|                                                                                     | <u>RAPORT KONSTRUKTIV</u>                                                                        |  |                |

# **RAPORT**

**MBI VLERESIMIN E AFTESISE MBAJTESE  
STRUKTURORE TE OBJEKTIT EGZISTUES**

**“ISH – REPARTI RENE A”**

**Autore**

**Ing. Dhimiter PAPA Nr.Liç. K.1510/2**

**Tirane, 2020**

## ABSTRAKT

*Ne kete analize kemi te bejme me nje objekt te ndertuar pas vitit 1973 i cili do te studiohet nga ana strukture me qellim vleresim e kushteve dhe gjendjes se godines kryesisht ne lidhje me performancen dhe kapacitetin sizmik. Metodologjia perfshin prova in-situ (ne terren), teste laboratorike, aplikim te metodave analitike, konsiderimin e parametrave gjeoteknike dhe sizmitetin e zones. Ngarkesat sizmike jane vleresuar duke u bazuar ne metoda bashkohore si edhe konceptet e perdorura me pare. Ky dokument paraqet nje procedure te mire ezaauruar mbi vleresim e kapacitetit sizmik te struktures me konstruksion mbajtes kryesisht murature, ne rastin e eventeve sizmike te fuqishme. Analiza qe kryhet eshte teresore, per ndertesën ne shkalle globale dhe per elementet e vecante ne nivel lokal me fokus ne zonat me predispozim me te larte ndaj humbjes se qendrueshmerise dhe shkaterrimit. Kjo analize kryhet nepermjet modelimit me metoden e elementeve te fundem e cila mundeson zgjidhje efektive dhe saktesi shume te larte duke perfshire sjelljen brenda dhe jashte planare te elementeve per te arritur ne nje vleresim perfundimtar mbi mekanizmat e kolapsit lokal dhe global.*

## PERMBAJTJA:

### 1. GJENDJA FIZIKE AKTUALE E OBJEKTIT

#### 1.1. Vendndodhja e objektit

#### 1.2. Te dhena gjeologjike dhe sizmike te bazamentit

##### 1.2.1. Gjeologjia e zones

##### 1.2.2. Shtresat perberese te bazamentit

##### 1.2.3. Aktiviteti sizmik

#### 1.3. Vetite fiziko-mekanike te materialeve te perdorura ne godine

##### 1.3.1. Celiku

##### 1.3.2. Betoni

##### 1.3.3. Muratura

##### 1.3.4. Rezistencat

### 2. MODELIMI 3D I STRUKTURES

#### 2.1. Principet e modelimit 3D

#### 2.2. Imputet e modelit

#### 2.3. Analiza

#### 2.4. Rezultatet nga analiza mbi modelin

### 3. KONKLUZIONET

**\*Materialet e perdorura/ne dispozicion ne te cilat eshte mbeshtetur grupi i punes:**

-Projekti arkitektonik i plote i ndertesës, planimetritë, pamje, prerje etj.

-Projekti konstruktiv i ndertesës.


-Vezhgimi i objektit ne fakt, rilevimi dhe matjet faktike te realizuara nga grupi i punes se aktit te ekspertimit.

-Programe te avancuara kompjuterike TEKLA STRUCTURAL DESIGNER 2019 dhe ETABS ULTIMATE 2017.

-Harta gjeologjike e qytetit te Kamzes si dhe studime Gjeologjike te shesheve te ngjashem, te realizuara nga autore te ndryshem si edhe nga instituti i Gjeologji Miniera 1967 – 1990.

-Harta e mikrozonimit Sizmik te Republikes se Shqiperise.

- VENDNDODHJA:



Objekti me pese kate ndodhet ne rrugen “Muhamet Deliu”, Bashkia “Tirane” me koordinata 41.351123 N ; 19.869424 E




## 1. GJENDJA FIZIKE AKTUALE E OBJEKTIT


### 1.1. TE DHENA GJEOLGJIKE DHE SIZMIKE TE BAZAMENTIT

#### 1.1.1. Gjeologjia e zones


Per sheshin e ndertimit te objektit egzistues ne fjale dhe per qellime te aktit te ekspertizes ne lidhje me aftesine mbajtese te nderteses me destinacion banim mbi kete shesh, jane perdorur te dhena te marra nga studime gjeologo-inxhninerike te kryera per sheshe te tjera fqinje, ne largesi jo me shume se 200 metra ne vije ajrore nga sheshi ne fjale si edhe nga Harta Gjeologjike e Qytetit te Tiranes.



Harta Gjeologjike e Tiranes Shkalla 1:200 000



Pleistocen-Holocen. Depozitime te perziera aluviale-proluviale, rere, zhavore, alevrite



Mioceni siperm. Ranore dhe Argjila ne Depresionin e Tiranes

Serravalian. Argjila, ranor dhe gelqerore melitotamnie ne zonen Jonike dhe Ultesires Adriatike.



N<sub>1s</sub><sup>2</sup>



Harta tektonike e Tiranës me Shkallë 1:200 000

F

Depozitimet Flishore (argjila, mergele, ranore)



Rreshqitje



Zonat e rreshqitjeve




Shkeputje aktive


### 1.2.2. Shtresat perberese te bazamentit

Te dhenat gjeologjike jane marre nga studime te kryera per objekte te ngjashem ne afersi te objektit tone. Duke permbledhur materialet e studimeve te ndryshme te shqyrtuara dhe duke u mbeshtetur edhe ne Harten Gjeologjike te Tiranes si dhe ne studime te shumta te kryera nga instituti i Gjeologji Miniera 1965 – 1990, eshte pranuar profili stratigrafik i meposhtem, perfaqesuar nga 5 shtresa gjeologjike me veti dhe karakteristika te ndryshme. Profili i detajuar si dhe karakteristikat dhe vetite e shtresave, per nje pakete me trashesi rreth 17 metra, nga siperfaqja e tokes natyrale jepen ne menyre te detajuar si me poshte.

PROFILI GJEOLGJIK S1-S2



### Legjenda



Mbushje te reja argjilo-copezore ngjyre kafe vegjetale




Suargjila te mesme me ngjyre kafe te kuqerremta me pak lageshtire, plastike deri te forta, permbajne guraleca te shumte ranorike te imet jane mesatarisht te ngjeshura.



Suargjila te mesme me ngjyre kafe me permbajtje copash dhe zhavori ranorik ngjyre kafe, jane me shume lageshtire, ne gjendje plastike te bute jane pak te ngjeshura.



Suargjila te mesme me ngjyre bezhe, me pak lageshti, plastike, jane mesatarisht te ngjeshura



Zhavore gelqerore suargjilore me ngjyre kafe bezhe, jane koker vogla deri koker medha, ralle edhe popla, te ngopura me uje pas 8.3m , jane mesatarisht deri te ngjeshur.

Per te evidentuar shtresat dhe formacionin perberes, jane perdorur studime te ngjashme, me shpime me thellesi **15 m** deri **16 ml**, si dhe jane realizuar, analiza granulometrike sipas metodikes A.S.T.M.D. 422, analiza Atterberg Limits sipas metodikes AASHTO DESIGNATION: T 89-94 dhe T 90-94, teste Odeometric Test sipas ASTM D 2435, teste Shear Test sipas metodikes ASTM D 3080, prova te tipit S.P.T. sipas metodikes (ISSMFE Techn. Committee 1988. International Reference Test Procedure). Ne perfundim eshte bere interpretimi i te dhenave in-situ, te dhenave te laboratorit dhe hartimi i raportit perfundimtar.

Mbeshtetur ne vrojtimet e kryera ne terren dhe materialet e marra nga shpimet e kryera per objekte ne afersi, perberjen litologjike, kushtet e formimit te sheshit te ndertimit, si dhe te dhenat nga analizat laboratorike ne rastet e mesiperme, ne baze te te dhenave te marra nga keto shpime, ne sheshin e ndertimit konkludohet se mund te vecohen **5 shtresa** gjeologjike me veti fiziko mekanike te ndryshme, te cilat po i trajtojme me hollesi me poshte:

**Shtresa 1:** Kjo shtrese perfaqesohet nga mbushje te reja argjilo-copezore ngjyre kafe vegjetale si dhe material te ndryshme nga veprimtaria e banoreve te zones. Shtresa ka trashesi rreth **0.8m**.

**Shtresa 2:** Perfaqesohet nga suargjila te mesme me ngjyre kafe te kuqerremta me pak lageshtire, plastike deri te forta, permbajne guraleca te shumte ranorike te imet jane mesatarisht te ngjeshura. Shtresa ka trashesi rreth **4.0m**.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese (**SHTRESA NR. 2**) jane:

#### **Granulometria:**

|                    |                 |                |
|--------------------|-----------------|----------------|
| Fraksioni argjilor | (<0.002mm)      | 14.00 %        |
| Fraksioni pluhuror | (<0.002-0.06mm) | 58.00 %        |
| Fraksioni ranor    | (>0.06mm)       | 28.00 %        |
| Lageshtia natyrore |                 | $W_n=22.00 \%$ |

#### **Kufijte e Atterbergut**

|                                    |                                 |
|------------------------------------|---------------------------------|
| Kufiri i siperm i plasticitetit    | $W_{rr} = 31.5 \%$              |
| Kufiri i poshtem i plasticitetit   | $W_p = 18.5\%$                  |
| Numri i plasticitetit              | $I_p=13\%$                      |
| Pesha specifike                    | $\delta = 2.69 \text{ T/m}^3$   |
| Pesha volumore ne gjendje natyrale | $\gamma = 1.92 \text{ T/m}^3$   |
| Koeficienti i porozitetit          | $\varepsilon = 0.71$            |
| Konsistenca                        | $B = 0.27$                      |
| Moduli i kompresionit              | $E = 120 \text{ kg/cm}^2$       |
| Kendi i ferkimit te brendshem      | $\phi = 18^\circ$               |
| Kohezioni                          | $c=0.20 \text{ kg/cm}^2$        |
| Ngarkesa e lejuar ne shtypje       | $\sigma = 2.40 \text{ kg/cm}^2$ |



**Shtresa 3:** Perfaqesohet nga suargjila te mesme me ngjyre kafe me permbajtje copash dhe zhavori ranorik me ngjyre kafe, jane me shume lageshtire, ne gjendje plastike te bute, jane pak te ngjeshura. Shtresa ka trashesi rreth **0.7m**.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese (**SHTRESA NR. 3**) jane:

**Plasticiteti (Kufijte e Atterbergut)**

|                                    |                                |
|------------------------------------|--------------------------------|
| Lageshtia natyrore                 | $W_n=35.00 \%$                 |
| Pesha specifike                    | $\delta = 2.65 \text{ T/m}^3$  |
| Pesha volumore ne gjendje natyrale | $\gamma= 1.91 \text{ T/m}^3$   |
| Koeficienti i porozitetit          | $\varepsilon = 0.87$           |
| Konsistenca                        | $B = 0.65$                     |
| Moduli i kompresionit              | $E = 50 \text{ kg/cm}^2$       |
| Kendi i ferkimit te brendshem      | $\varphi = 14^\circ$           |
| Kohezioni                          | $c=0.12 \text{ kg/cm}^2$       |
| Koeficienti i Puasonit             | $\nu=0.34 \text{ kg/cm}^2$     |
| Ngarkesa e lejuar ne shtypje       | $\sigma = 1.2 \text{ kg/cm}^2$ |

**Shtresa 4:** Perfaqesohet nga suargjila te mesme deri argjila me ngjyre bezhe te verdha, jane me lageshtire ne gjendje plastike deri te forta, mesatarisht deri te ngjeshura.

Shtresa ka trashesi rreth **3.5m**.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese (**SHTRESA NR. 4**) jane:

**Granulometria:**

|                    |                 |         |
|--------------------|-----------------|---------|
| Fraksioni argjilor | (<0.002mm)      | 24.00 % |
| Fraksioni pluhuror | (<0.002-0.06mm) | 67.00 % |
| Fraksioni ranor    | (>0.06mm)       | 9.00 %  |

**Plasticiteti (Kufijte e Atterbergut)**

|                                    |                               |
|------------------------------------|-------------------------------|
| Kufiri i siperm i plasticitetit    | $W_{rr} = 37.50 \%$           |
| Kufiri i poshtem i plasticitetit   | $W_p = 24.00 \%$              |
| Numri i plasticitetit              | $I_p= 13.50 \%$               |
| Pesha specifike                    | $\delta = 2.72 \text{ T/m}^3$ |
| Pesha volumore ne gjendje natyrale | $\gamma= 1.92 \text{ T/m}^3$  |
| Lageshtia natyrore                 | $W_n=27.00 \%$                |
| Koeficienti i porozitetit          | $\varepsilon = 0.80$          |
| Moduli i kompresionit              | $E = 150 \text{ kg/cm}^2$     |

|                               |                                 |
|-------------------------------|---------------------------------|
| Kendi i ferkimit te brendshem | $\varphi = 18^\circ$            |
| Kohezioni                     | $c=0.22 \text{ kg/cm}^2$        |
| Ngarkesa e lejuar ne shtypje  | $\sigma = 2.40 \text{ kg/cm}^2$ |

**Shtresa 5:** Kjo shtrese perfaqesohet nga zhavore gelqerore suargjilore me ngjyre kafe, jane koker vogla deri koker medha, rralle edhe popla, jame te perpunuara mire me pak lageshti deri 8.3m dhe me lageshtire nen nivelin e ujit nentokesor, masa suargjilore eshte e ulet dhe e ngopur me uje, jane mesatarisht te ngjeshura. Shtresa ka trashesi rreth **9m**.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese (**SHTRESA NR. 5**) jane:


|                                    |                                |
|------------------------------------|--------------------------------|
| Pesha specifike                    | $\delta = 2.65 \text{ T/m}^3$  |
| Pesha volumore ne gjendje natyrale | $\gamma = 1.98 \text{ T/m}^3$  |
| Lageshtia natyrore                 | $W_n = 25.5 \%$                |
| Moduli i kompresionit              | $E = 200 \text{ kg/cm}^2$      |
| Kendi i ferkimit te brendshem      | $\varphi = 28^\circ$           |
| Kohezioni                          | $c = 0.05 \text{ kg/cm}^2$     |
| Ngarkesa e lejuar ne shtypje       | $\sigma = 2.5 \text{ kg/cm}^2$ |

**Niveli i ujit nentokesor (N.U.N)** eshte rreth 6.1m nga sipërfaqja e tokes. Nga analizat e kryera keto ujera nuk jane agresive kundrejt hekurit dhe betonit.

### 1.2.3. Aktiviteti Sizmik

Mbeshtetur ne Punimet ``Sizmiciteti Sizmotektonika dhe Vleresimi i Riskut Sizmik ne Shqiperi`` (me Autore Aliaj. etj. 2010), Raportin mbi Mikrozonimin Sizmik te Qytetit te Tiranes (Koçiaj etj. 1988) publikuar nga Akademia e Shkencave e Shqiperise dhe ne studime te shumta Inxhiniero Sizmologjike te kryera ne qytetin e Tiranes nga Instituti i Sizmologjise si edhe ne te dhenat e Studimit Gjeologo Inxhinierik, Per sheshin e ndertimit, jane percaktuar parametrat sizmike te nevojshem per llogaritjet e kontrollit te strukture.

Ne perfundim, duke studiuar rezultatet e Studimit Gjeologo Inxhinierik dhe atij Inxhiniero Sizmiologjik, për vleresimin e rrezikut sizmik me programin kompjuterik **SHAKE 2000** te sheshit te ndertimit të Objektit ne Tirane, autoret kane arritur ne **perfundimet** e meposhtme: Sheshi i ndertimit në studim klasifikohet si truall i kategorisë së II-të sipas KTP-N.2-89, truall i Klases C sipas EC-8, (EC-8, 2004). Sipas Kodit Shqiptar të Projektimit KTP N.2 - 89 parametrat për sheshin konkret të ndertimit janë: intensitet 7.5 ballë (MSK-64), truall i kategorisë së II-të:  $k_E = 0.165 \text{ g}$ ,  $\beta(T) = 2.0$ , dhe shpejtimi spektral maksimal :  $S_a(T) = 0.165 \times 2.0 = 0.330 \text{ g}$ ,  $T_C = 0.4 \text{ sek}$ ,  $T_D = 1.23 \text{ sek}$ .



1. Parametrat kryesore te rrezikut sizmik të sheshit te ndërtimit në studim në kushte trualli shkëmbor ( $V_s, 30 = 760$  m/sek) janë: për periudhë përsëritje 475 vjet: shpejtimi maksimal  $PGA = 0.280$  g, ndersa shpejtimi spektral në periodën 0.2 sek  $S_a(0.2 \text{ sek}) = 0.615$  g dhe per perioden 1.0 sek  $S_a(1.0 \text{ sek}) = 0.183$  g.

2. Sipas Eurokodit 8, spektri elastik i reagimit per shtresen e mbështetjes se bazamentit te objektit te studiuar mund te konsiderohet si me poshte: Per probabilitet 10 % / 50 vjet për kategorinë C të truallit sipas EC-8 rezultojnë parametrat: shpejtimi maksimal  $a_0 = 0.278$  g dhe shpejtimi spektral maksimal  $S_e(T) = 1.162$  g,  $S = 1.15$ ,  $T_B = 0.2$  sek,  $T_C = 0.6$  sek, dhe  $T_D = 2.0$  sek.

3. Per llogaritjen e struktures te objektit ne shqyrtim rekomandojme perdorimin e spektrit elastik te reagimit sipas Eurokodit 8 me parametrat e mesiperm, per probabilitetin 10 % / 50 vjet.

4. Nje parameter i rendesishem per reagimin dinamik te truallit jane periodat e vibrimit te pakos se depozitimeve dherore te vendosura mbi shkembijte rrenjesore. Perioda

e vibrimit te truallit sipas spektrit te reagimit te nxitimit spektral, nga llogaritjet me programin SHAKE2000 per nivelin 15 m, vihet re ne brezin e periodave  $T_s = 0.08$  deri 0.4 sek.

*Ne perfundim mund te themi se per vendosjen e themeleve ne thellesine 1.60 m si parameter i rrezikut sizmik eshte pranuar per vleresim koeficienti i sizmicitetit  $PGA = 0.270$  \*g. Kjo vlere eshte perdorur per vleresimin e performances se mbistrukture dhe themelit.*

### 1.3. Vetite fiziko-mekanike te materialeve te perdorura ne godine


Materialet që janë përdorur për strukturën (betoni dhe çeliku) duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në KTP si dhe ato të parashikuara në Eurocode.

#### 1.3.1. Çeliku

Çeliku i armimit i përdorur, duhet të gëzojë veti të mira si në rezistencë ashtu edhe në deformueshmëri (duktilitet) për të përmbushur kriteret e performances sizmike. Në elementët parësorë për armaturën e hekurit është përdorur çelik i tipit B500c.



Çelik B500C,  $f_{ys} = 50\,000\text{ kN/m}^2$ ,  $f_{us} = 60\,000\text{ kN/m}^2$ ,  $E = 21\,000\,000\text{ kN/m}^2$ ,  $\gamma_s = 1.15$ ,  $\varepsilon_{sy} = 0.25\%$ ,  $\varepsilon_{su} \geq 0.10\%$



- Diagrama sforcim-deformim e çelikut B500C

Armatura e Zakonshme

| Klasa e Çelikut te Zakonshem               | B500C                                         |
|--------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Rezistenca Karakteristike e Rrjedhshmerise | $f_{yk} = 500\text{ MPa}$                     |
| Rezistenca Karakteristike e Shkaterrimit   | $f_{tk} = 600\text{ MPa}$                     |
| Moduli i Elasticitetit                     | $E_s = 210\,000\text{ MPa} = 210\text{ GPa}$  |
| Koeficienti i Sigurise Parcialë te Çelikut | $\gamma_s = 1.15$                             |
| Rezistenca Llogaritese e Çelikut           | $f_{yd} = f_{yk} / \gamma_s = 435\text{ MPa}$ |
| Rezistenca Llogaritese e Çelikut ne Prerje | $F_{ywd} = 500\text{ MPa}$                    |
| Koeficienti i Puassonit                    | $\nu = 0.30$                                  |

*ÇELIKU PER ARMIMIN E KONSTRUKSIONIT BETON ARME (STEEL FOR REBAR B500C)*

Characteristic tensile stress  $f_{tk} = 600\text{ MPa}$

Characteristic yield stress  $f_{yk} = 500\text{ MPa}$

Characteristic ratio tensile/yield  $1.3 \leq (f_t/f_y)_k \leq 1.35$

Elastic Modulus  $E = 210\text{ GPa}$ , Elongation  $\geq 12\%$


### 1.3.2. Betoni

Ne perputhje me EC2, betoni i klasës C12/15 eshte perdorur per realizmin e themelit tip rrip i kryqezuar eton i klases C20/25 eshte perdorur per realizimin e elementeve te mbistrukture.

*Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C20/25)*


Beton C20/25

$f_{ck} = 20\text{ kN/cm}^2$ ,  $f_{cd} = 14.16\text{ kN/cm}^2$ ,  $\gamma_c = 1.5$ ,  $\varepsilon_{cy} = 0.20\%$ ,  $\varepsilon_{cu} \geq 0.35\%$



### 1.3.3. Muratura

Bazuar te EC6 (3.6.2 (7)), muratura e perdorur eshte e ndertuar me tulla te markes M75 dhe llac M25. Me kete murature eshte realizuar konstruksioni mbajtes i cili sherben per transferimin e ngarkesave te nderkateve ne bazament dhe perballimin e forcave horizontale sizmike, dhe ai ndares i cili sherben per ndarjen e ambjenteve te brendshme.



*Marredhenia sforcim-deformim per punen e muratures ne shtypje aksiale*

*Parametrat e muratures (Tulle M75/Llac M25)*


$f_k = K_E * f_b^a * f_m^B$ ,  $a = 0.7$ ,  $B = 0.3$ ,  $f_b \leq 75 \text{ N/mm}^2$ ,  $f_m \leq 20 \text{ N/mm}^2$ ,  $K_E = 0.45$  (Murature e grupit te dyte),

$$f_k = 0.45 * 70^{0.7} * 25^{0.3} = 23 \text{ N/mm}^2$$


$$E = K_E * f_k = 1000 * 23 = 23\,000 \text{ kN/m}^2, \quad E_{\text{long time}} = E / (1 + \phi_\infty) = 23000 / 1.5 = 15\,300 \text{ kN/m}^2$$

$$G = 0.4 * E = 9\,000 \text{ kN/m}^2$$


- Shkaterrimi i muratures nen veprimin e momentit perkules:



- Planet e shkaterrimit per muraturen ne perkulje



- Marredhenia force-zhvendosje e pergjigjes se nje muri te paperforcuar, pa rezistence ne terheqje dhe me sjellje elastike ne shtypje.



- VETITË MEKANIKE TË MURATURËS NË SHTYPJE QENDRORE

1. Gjendja e nderur e muraturës në shtypje qendrore.

Tulla dhe llaçi ndodhen në një gjendje të sforcuar të komplikuar madje edhe për ngarkesë uniformisht të shpërndarë. Ata ndodhen në kushtet e punës të shtypjes qendrore, jashtëqendrore, shtypje lokale, përkulje, prerje, tërheqje. Arsyet janë:

❖ Në jonjëtrajtshmërinë e llaçit

Kjo ndodh për:


- a. Jonjëtrajtshmëria e lëndës lidhëse (çimentos, gëlqeres etj.)
- b. Jonjëtrajtshmëria e lëndës mbushëse (rërë)
- c. Kushte jo të barabarta ngurtësimi, pasi:
  - Aftësia e ndryshme e thitjes së ujit në zona të veçanta të tullave, në zonat e kontaktit
  - Aftësia për të mbajtur ujin në fugat është e ndryshme në zona të ndryshme

d. Procesi i ngurtësimit të llaçit shoqërohet me fenomenin e tkurrjes.

Tkurrja është e madhe sa më e madhe të jetë sasia e ujit që humbet llaçi gjatë ngurtësimit. Humbja e ujit është e ndryshme gjatë kontaktit të tullave me llaçin kështu që edhe tkurrja është e ndryshme. Tkurrja pengohet nga tullat nga kohezioni dhe forcat e fërkimit. Aty ku tkurrja nuk përballohet nga forca e kohezionit dhe fërkimi llaçi shkëputet nga tulla. Pra, këto të fundit nuk mbështeten plotësisht mbi llaç, krijohen boshllëqe.


e. Faktori subjektiv

Gjatë ndërtimit nuk mund ta shtrihet llaçi në mënyrë të atillë që të krijojë mbështetje uniforme në faqen e poshtme të tullës edhe duke i rënduar tulles mbi llaç.



2. Ndryshimi i vetive të deformimit. Deformimet gjatësore shoqërohen edhe me deformime tërthore të cilat kanë influencë të madhe në rezistencën e muraturës. Si rezultat i deformimeve jo të barabarta (tulla dhe llaçi) dhe I punës së përbashkët do të lindin nderje tërheqëse në materialin me ngurtësi më të madhe (tulla) dhe shtypëse në atë me ngurtësi më të vogël (llaçi). Kështu pra duke qenë se ngurtësia e llaçit është më e vogël tek tulla lindin nderje tërthore tërheqëse.





Etapat e gjendjes së nderur të muraturës në shtypje qendrore.

### Etapa 1

Kjo etapë fillon me ngarkimin e muraturës dhe vazhdon për gjithë fazën e ngarkimit në të cilën muratura reagon ndaj ngarkesave vepruese pa pësuar plasaritje. Në këtë etapë për arsye të gjendjes së nderur shtypëse të vogël deformimet tërthore janë relativisht të vogla dhe zgjojnë nderje tërheqëse që përballohen mirë nga muratura.

### Etapa 2

Me ngarkimin e muraturës mbi etapën 1 vjen një moment kur nderjet tërthore tërheqëse, të shkaktuara nga deformimi tërthor i muraturës marrin vlerë më të madhe se ato kufitare të muraturës sipas seksionit vertikal të lidhur dhe kështu bëhen shkas për lindjen e të plasurave të imta (të holla) vertikale që kalojnë gjatë fugave vertikale dhe tullave (gurëve) atje ku rezistenca në tërheqjen e tyre është më e vogël. Në këtë etapë që quhet etapa e lindjes së plasjeve në muraturë, mbi muraturë vepron ngarkesa e shkaktimit të të plasurave Npl.

Duhet theksuar se momenti i lindjes së të plasurave varet si nga vetitë e tullës apo gurit, nga cilësia e muraturës dhe mbi të gjitha nga vetitë e llaçit me të cilin është ndërtuar muratura provë. Kështu për markë të caktuar të tullës, përdorimi i llaçeve të markave të larta dhe pak të deformueshme rrit aftësinë mbajtëse ndaj plasjeve të muraturës dhe e kundërta përdorimi i llaçeve të gëlqeres e ul shumë aftësinë mbajtëse ndaj plasjeve apo vlerën Npl.

Shfaqja e plasjeve të para në muraturë për ngarkesë vertikale, relativisht jo shumë të madhe hodhën dritë mbi punën e dobët të muraturës në tërheqje prej deformimeve tërthore çka duhet të vihet parasysh gjatë studimit të konstruksioneve prej guri sidomos në kushtet e vendit tonë si rajon sizmik.


### Etapa 3

Me rritjen e ngarkesës mbi Npl gjendja e nderur rritet, po ashtu edhe ajo e deformuar. Si pasojë e rritjes së deformimeve tërthore rriten edhe nderjet tërheqëse tërthore dhe si pasojë vazhdon hapjen e plasjeve vertikale dhe thellimi i tyre. Këto plasje duke u zgjeruar dhe bashkuar midis tyre edhe me

fugat vertikale të muraturës e ndajnë muraturën në degë të vogla vertikale ku secila punon në shtypje qendrore apo jashtëqendrore. Në këtë fazë elementi apo muratura ka hyrë në etapën e tretë. Eksperimenti ka treguar se në këtë etapë edhe po ta mbajmë ngarkesën konstante vazhdon zhvillimi dhe rritja e të plasurave. Kjo tregon se muratura është në prag të shkatërrimit të saj. Duhet theksuar se në këtë etapë këte proces të zhvillimit të plasaritjeve e favorizon edhe fenomeni i epjes së degëve apo kollonave të krijuara.

#### Etapa 4

Me rritjen e ngarkesës pak mbi atë të etapës së tretë eksperimentet tregojnë se kemi zhvillim të vullshëm të deformimeve tërthore, hapje të theksuar të çarjeve vertikale të cilat favorizohen edhe nga puna me epje të degëve apo kollorikave vertikale deri sa vjen një moment kur muratura shkatërrohet si pasojë e arritjes së ngarkesës shkatërruese  $N_{sh}$ . Kjo është etapa e 4.




#### Puna e muraturës në prerje.

Dallojmë dy raste të veprimit të forcës prerëse:

##### a. Sipas prerjeve të palidhura

Këtu forca prerëse përballohet nga kohezioni tangencial dhe nga forca e fërkimit midis tullave dhe llaçit (në përpjestim të drejtë në sforcimin normal) nderjet shtypëse kur  $\sigma_n = 0$   $\tau_f = 0$



##### b. Sipas prerjeve të lidhura

Duke neglizhuar fugat vertikale, këtu forca prerëse përballohet nga vetë tullat dhe rezistenca e llogaritjes merret e barabartë me rezistencën në prerje të tullës dhe sipërfaqje faktive sa ajo e tullave jo sipas gjithë seksionit.

#### 1. Shtypja lokale


Takojmë shpesh raste kur nderjet shtypëse veprojnë në një pjesë të kufizuar të elementit kurse në pjesën tjetër nderjet janë praktikisht zero. Rezistenca e muraturës në shtypje lokale është më e madhe se rezistenca e muraturës në shtypje qendrore. Kjo ndodh sepse pjesë e pangarkuar apo më pak e ngarkuar pengon deformimet e pjesës më të ngarkuar duke bërë që të rritet kufiri i rezistencës në këtë zonë.

##### 1. Ndikimi i rezistencës së llaçit

Llaçi ndikon në rezistencën e muraturës në mënyrë të ndjeshme. Për të njëjtën klasë tulle rritja e rezistencës së muraturës është më e ndjeshme për vlera të ulta të rezistencës së llaçit.

##### 2. Ndikimi i cilësisë së muraturës në rezistencën e saj

Sa më i njëtrajtshëm të jetë llaçi aq më mirë sigurohet mbështetja e tullës dhe aq më homogjene është



muratura dhe aq më e njëtrajtshme është gjendja e sforcuar.

### 3. Ndikimi i trashësisë së fugave horizontale

Rezistenca e muraturës ndryshon në varësi nga lartësia dhe trashësia e fugave.

Faktorë të tjerë:

Temperatura

Përmasat dhe forma e elementëve muratures

Mënyra e lidhjes së rrjeshtave


Kapja apo jo e llaçit me tullat

### Puna e muraturës në tërheqje qendrore


#### a. Tërheqja ndodh sipas seksioneve të palidhura

Gjatë tërheqjes së muraturës sipas prerjeve tërthore të palidhura forca normale vepron pingul me fugat horizontale. Kurse shkatërrimi mund të ndodhë:

- Sipas 1-1 gjatë sipërfaqes së kontaktit të tullave me llaçin
  - Sipas 2-2 gjatë vetë llaçit të fugaturës horizontale
  - Sipas 3-3 gjatë vetë tullave
  - Sipas 4-4 një kombinim i rasteve të mësipërme
- b. Tërheqja ndodh sipas seksioneve të lidhura



Në këtë rast forca normale vepron paralel me fugaturat horizontale. Shkatërrimi mund të ndodhë:



- Sipas 1-1 seksioni i dhëmbëzuar që kalon nëpër fugat horizontale dhe vertikale
- Sipas 2-2 seksioni që kalon nga fugat vertikale dhe vetë tullat
- Sipas 3-3 seksioni i shkallëzuar që kalon nëpër fugat vertikale dhe horizontale


#### c. Shkaqet e shkatërrimit të muraturës në tërheqje qendrore sipas seksioneve të palidhura

Në shumicën e rasteve shkatërrimi ndodh sipas 1-1 d.m.th. sipas kontaktit të tullave me llaçin, sipas fugave horizontale ç'ka ndodh atëherë kur kohezioni midis tullave dhe llaçit është më i vogël se sa rezistenca në tërheqje e llaçit ndërsa kur kohezioni është më i madh plasaritja kalon gjatë 2-2 (mes për mes fugës horizontale, ç'ka ndodh rrallë).



Forca e kohezionit (normal) midis tullës dhe llaçit varet mbi të gjitha nga kufiri i rezistencës së llaçit. Por krahas kësaj ndikim anësor kanë edhe faktorë të tjerë si përbërja e llaçit (lloji i llaçit), lëvizshmëria apo plasticiteti i tij, aftësia ujëmbajtëse e tij, lloji i tullës, aftësia e tullës për të thithur ujë, ashpërsia e tullës, kushtet klimaterike etj. Për të rritur kohezionin duhet të përdorim llaçe me përmbajtje optimale çimento, gëlqere, rërë, duke siguruar lëvizshmëri, plasticitet.

d. Tërheqja e muraturës sipas prerjeve tërthore të lidhura.

e. Në këtë rast kur kohezioni midis tullave dhe llaçit është i vogël plasaritjet kalojnë sipas fugave vertikale dhe horizontale duke krijuar seksione të dhëmbëzuara ose të shkallëzuara. Rezistencën e fugave vertikale nuk e marrim parasysh sepse nga mbushja jo e mirë dhe nga ulja e llaçit kohezioni në këto fuga është i barabartë me zero. Kështu forca tërheqëse thithet vetëm nga fuga horizontale. Shkatërrimin e fugave e pengon kohezioni tangencial në planin e fugës. Kjo forcë varet nga po ata faktorë si dhe forca e kohezionit normal.



*Transferimi ne murature i ngarkeses nga elemente horizontale*



Konstruksioni i objekteve me skeme konstruktive te shtanget eshte i nevojshme te llogaritet nen veprimin e ngarkesave vertikale dhe horizontale duke marre parasysh kombinimin e mundshem te tyre. Llogaritja e muratures apo kolonave nga verimi i ngarkesave vertikale dhe horizontale prej eres ne objektet me skeme konstruktive te shtanget behet duke i trajtuar ato si trare vertikale te vazhduar te mbeshketur mbi mbeshketje te palevizshme sic jane mbulesat (VI-fig 4/a,b,c)

Diagrama e momenteve per nje supozim te tille, si tra i vazhduar do te ishte ajo e treguar ne fig 4b. Por me qellim thjeshtimi te llogaritjes dhe ne favor te aftesise

mbajtese, murin apo kolonen shumekateshe mund ta trajtojme si te zberthyer ne nje sere traresh me nje hapësire drite te mbeshketur ne drejtimin horizontal ne mbulesat e kateve. Per nje supozim te tille, diagrama e momenteve prej forces vertikale jashteqendrore eshte si ne fig 4b. Hapesira e drites e traut vertikal te nderprere (murit apo kolones) merret e barabarte me lartesine e katit dysHEME-tavan, ndersa si aks vertikal i muratures merret aksi qe kalon ne qendren e rendeses se murit te marre ne studim. Nje element i tille (tra vertikal me nje hapësire drite) ndodhet ne veprimin e ngarkesave qe vijne nga katet e mesiperme duke marre parasysh peshen vetjake te mureve mbi katin e marre ne studim dhe duke i pranuar qe ato veprojne ne qendren e murit qe mbeshketet mbi kete kat; nen veprimin e reaksionit te nderkatit qe mbeshketet ne anen e sipërme te traut te marre ne studim, i cili vepron me jashteqendresi "e" te barabarte me distancën nga qendra murit ne fjalet, deri te qendra e diagrames se presionit te mbuleses te pranuar




ne forme trekendeshi, nen veprimin e eres. (Marrja parasysh e termetit behet si ne udhezuesin e projekteve antisizmike). Pra, moment perkules ne traun e pranuar jep ngarkesa jashteqendrore e mbuleses ne mbeshtetjen e sipërme dhe muri mbi te nese ai nuk ka trashesi te njejte me ate te murit te marre ne studim.

Ne kete menyre, per rastin si ne fig VI-4a, forca normale prej ngarkeses se nderkatit, per murin e marre ne studim, do te jete:

$$N_i = \sum N_s + R_i$$

Ku:  $\sum N_s$  - shume e ngarkesave prej peshes se mureve dhe nderkateve (mbulesave) qe ndodhen mbi murin e marre ne studim

$R_i$  - reaksioni prej mbuleses se nderkatit te mbeshtetur mbi murin e marre ne studim



VI- fig 4/a,b,c

Ndersa momenti perkules ne kuoten e poshtme te nderkatit per murin e marre ne studim, kur trashesia e mureve eshte e barabarte (fig. VI-5a) do te jete:

$$M_i = R_i \cdot e$$

Per rastin kur trashesia e murit mbi ate te marre ne studim eshte me e vogel atehere, ne momentin perkules, duhet te marrim parasysh edhe momentin prej  $\sum N_s$  me shenje perkatese (fig. VI-5b). Ne kete rast ddo te kemi:

$$M_i = -\sum N_s \cdot e_1 + R_i \cdot e$$


Ku:  $e$  - largesia nga qendra e rendeses se murit deri ne qender te reaksionit  $R_i$  e barabarte me:

$$e = \frac{a}{2} - \frac{c}{3}$$

$e_1$  - largesia nga qendra e rendeses se murit te siperm deri te qendra e rendeses se murit te marre ne studim.

$a$  - trashesia e murit te marre ne studim (per prerje katerkendore)

$c$  - thellesia e mbeshtetjes se nderkatit apo traun ne murature



VI-fig 5/a,b

Edhe ndikimi i ngarkeses se eres mbi muret gjatesore te objektit (si veprimi me i disfavorshem) merret parasysh. Nga veprimi i ngarkesave te eres mbi murin gjatesor lindin momente perkulese (fig.6) dhe forca normale. Per llogaritjen e momentit perkules prej eres, murin e trajtojme si tra te vazhduar (ne drejtim vertikal si ne fig.4/a) per te cilin momenti ne mbeshtetje do te jete:

$$M_p = \pm \frac{qH^2}{12} \quad (VI-5)$$

Meqenese momenti i eres per fazen e perfunduar te godines me skeme te shtanget jep vlera shume te vogla, keshillohet qe te mos merret parasysh ne llogaritje.

Pasi te kemi percaktuar forcat normale dhe momentet perkulese prej forcave vertikale, kalojme ne llogaritjen e muratures. Kontrolli i pare i muratures behet ne nivelin e mbeshtetjes se nderkatit (apo traute neqoftese ka tra)atje ku momenti perkules eshte me i madh ( fig.5a). Ne kete rast, meqe kemi te bejme me prerjen terthore ne mbeshtetje, koeficienti i perkuljes gjatesore  $\phi$  dhe madhesia  $m_g$  merren 1. Krahas prerjes nen mbeshtetje duhet te behet kontrolli i aftesise mbajtese te muratures edhe ne lartesi gjysmekati, ku ndoshta momenti eshte me i vogel, por koeficienti i perkuljes gjatesore  $\phi$  dhe  $m_g$  jane me te vegjel se 1. Ne qofte se gjate murit me karakter mbajtes ka dritare, atehere eshte e domosdoshme qe te provohet aftesia mbajtese edhe ne kuoten e sipërme te dritares ku kemi ngushtim te prerjes terthore, pra rritje te gjendjes se nderur. Llogaritja e muratures sipas aftesise mbajtese behet duke perdorur formulat e shtypjes jashteqendrore ne varesi te jashteqendresise  $e_o = M/N$ . Per llogaritjen e mureve me karakter mbajtes sipas aftesise mbajtese, kur ne to nuk ka dritare, merret ne studim nje rrip vertikal me gjeresi 1m ndersa per rastin kur kemi dritare, merret ne studim nje rrip me gjeresi sa largesia aks ne aks e dritareve.


### 1.3.4. Rezistencat

Rezistencat llogaritesen (te projektimit) per betonin dhe celikun jane marre nga reduktimi i rezistencave karakteristike sipas klases se betonit (apo celikut) te perdorur me faktorin e sigurise perkates si me poshte:

|                |                                                              |
|----------------|--------------------------------------------------------------|
| Per betonin:   | $f_{cd} = f_{ck}/\gamma_c$<br>$f_{c wd} = f_{c wk}/\gamma_c$ |
| Per celikun:   | $f_{yd} = f_{yk}/\gamma_s$<br>$f_{y wd} = f_{y wk}/\gamma_s$ |
| Per muraturen: | $f_{md} = f_{mk}/\gamma_m$<br>$f_{m wd} = f_{m wk}/\gamma_m$ |

## 2. MODELIMI 3D I STRUKTURES

### 2.1. Principet e modelimit 3D




Modeli matematikor perfaqeson nje idealizim te nje numri te caktuar elementesh si shell, frame, link, tendon dhe joint. Keto objekte brenda programeve perdoren per te perfaqesuar muret, soletat, kolonat, traret dhe objekte te tjere fizike. Sistemet konstruktive perfaqesohen nga nje rrjet tre dimensional. Sisteme reale teper komplekse mund te perfaqesohen me modele matematikore me te thjeshtuara. Duke perdorur metoden e llogaritjes me elemente te fundem merren rezultate shume te sakta ne lidhje me focat e jashtme dhe ato te brendshme. Rezultatet perfshijne edhe sjelljen ne perdredhje ose ate jashte planare. Zgjidhja e modelit tre dimensional mundeson nje perfshirje maksimale te kushteve reale ne te cilat punon objekti ne realitet.

Analiza mundeson studimin e veprimit te ngarkesave horizontale dhe vertikale mbi strukture. Programet ndjekin metoden e

dekompozimit te ngarkesave ku ngarkesat e shperndara ne soleta dekompozohen automatikisht ne ngarkesa nyjore te cilat transmetohen ne nyjet e trareve dhe me pas kolonave duke u shkarkuar ne bazament. Programet automatikisht gjenerojne ngarkesat e eres dhe ato sizmike te cilat perputhen me kodet e projektimit. Modet e lekundjes 3 dimensionale, format, frekuencat dhe periodat e lekundjeve te lira vleresohen me metoden Eigenvector ose Ritzvector. Gjithshtu programet ne varesi te kodit te projektimit mund te marrin ne konsiderate ne analizat statike dhe dinamike edhe efektet e P-Delta te cilat sjellin sforcime suplementare.

Nepermjet ketyre programeve mund te behen analiza te tipit Response Spectrum, Time History ose Push Over.

Metoda qe perdoret per vleresimin e kapacitetit strukturor te nderteses eshte ajo e analizes Push Over e cila eshte nje analize etipit Nonlinear Static. Ne kete analize te dhenat per veprimin sizmik merren duke i dhene struktures nje zhvendosje te njohur ne nje pike te caktuar. Kjo zhvendosje aplikohet ne menyre te njetrajtshme ku reagimi i struktures monitorohet ne menyre te vazhdueshme duke krijuar kurben e




kapacitetit strukturor deri ne momentin e krijimit te cernierave plastike ne trare dhe kolona. Duke krahasuar rezultatet e zhvendosjeve te marra nga analiza Response Spectrum (veprimi sizmik dhe ngarkesat vertikale) dhe ajo Push Over (kapaciteti i struktures), behet vleresimi i gjendjes se nderteses dhe aftesise se saj per te perbushur kushtet e sigurise dhe sherbimit.


- Marredhenia force-zhvendosje e cila perfaqeson kapacitetin e cernierave plastike te elementeve bazuar ne EC8

## 2.2. Inputet e modelit


Te gjithë elementet perberes te struktures perfaqesohen ne modelin 3D nepermjet objekteve te cileve u vendosen karakteristikat fiziko mekanike te elementeve reale. Kjo arrihet nepermjet te dhenave qe futen ne program te cilat jane paraqitur me poshte:




- *Materialet e perdorura per modelimin*



- *Seksionet e perdorura per llogaritjet*




- Te dhenat e perdorura per analizen sizmike Response Spectrum





- Llojet e ngarkesave te perdorura





-Kombinimet e ngarkesave

Objekti “ISH – REPARTI RENE” perfaqeson nje objekt me 2 kate mbi toke dhe nje kat nentoke, i rregullt ne plan dhe ne vertikaltet. Destinacioni kryesor eshte ai i sherbimit.



Struktura e objektit “PALLATI 153 & 153/1” eshte konceptuar dhe realizuar me konstruksion mbajtes me murature tulle te bardhe silikate me nderkate me trare dhe soleta betonarme (EC6 Unreinforced Masonry). Objekti i jep prioritet te dy drejtimeve perpendikulare per garantimin e zhvendosjeve te lejuara nga veprimet e ngarkesave te jashme, kryesisht atyre sizmike. Elementet konstruktive duhet te jene llogaritur dhe dimensionuar nen veprimin e ngarkesave maksimale te mundshme sipas kombinimit te ngarkesave.

Gjate procesit te analizes te kesaj ndertese, eshte vendosur, qe struktura te rimodelohet me 2 programe te avancuara kompjuterike, programin llogarites **TEKLA STRUCTURAL DESIGNER 2019** dhe ne **ETABS ULTIMATE 2017** per qellimet e ketij studimi. Struktura eshte modeluar sipas tipologjise se nderteses egzistuese, me 3 kate mbi toke (ku eshte respektuar thellesia e themeleve nga toka natyrore). Te 3 katet e

kesaj godine perdoren si ambjente sherbimi, kryesisht zyra.

**Themelet:** jane realizuar me rripa te kryqezuar prej murature guri dhe butobetoni, me thellesi te tabanit rreth 1.30 m referuar kuotes se tokes natyrale dhe rreth 1.95 m referuar kuotes 0.00 m te dyshemese ne katin perdhe. Ne funksion te numrit te kateve dhe te ngarkeses, qe perballojne dallojme gjeresi qe variojne nga 90 cm deri ne 120 cm.

**Muratura mbajtese:** eshte realizuar me tulla silikate kryesisht me gjeresi 38 cm ne katin nentoke dhe katin perdhe dhe me gjeresi 25 cm ne katin e pare. Muratura eshte e pa armuar. Sikurse ka rezultuar edhe nga provat laboratorike, por edhe nga vezhgimi i hollesishem ne terren, rezistenca e llacit eshte shume dobet dhe jo konform standarteve te referuara me siper. Llaci i muratures dhe i suvase jane pothuajse e njejta klase.

**Kolonat** ne pjesen e podrumit jane realizuar b/a me seksion  $b \times h = 30 \times 30$  cm.

**Traret** jane prej beton armeje me seksione te ndryshme si  $b \times h = 25 \times 40$  cm,  $b \times h = 25 \times 50$ ,  $b \times h = 50 \times 15$  dhe  $b \times h = 60 \times 15$ , etj.

**Muret ndarese** jane realizuar me tulla te kuqe me vrime me trashesi 25 cm, 20 cm dhe 12 cm.

**Soletat ose elementet siperfaqesore horizontale,** jane realizuar prej beton arme, te parapregatitura dhe qe ne praktike jane emertuar soleta tip SAP (SAP – Sernsa Armatura Provizore). Soletat kane lartesi te ndryshme ne funksion te hapësirave drite qe ato mbulojne, jane te mbeshetura ne nje drejtim, (te quajtura edhe soleta tip tra), dhe kane trashesi, qe varion nga 15 - 20 cm dhe me gjeresi 0.40 m deri 0.72 m ne soleten e podrumit dhe soleta monolite me trashesi 15 – 20 cm ne soleten e katit perdhe. Mbulesa e objektit eshte e realizuar me cati, me kapriata druri dhe tjegulla vendi.

### **Demtimet e Struktures nga termeti i dates 26.11.2019**

Struktura e objektit ka pesuar demtime te moderuara nga aktiviteti sizmik i Nentorit 2019, ku muret e katit te pare kryesisht kane demtime te konsiderueshme si: plasaritje terthore diagonale dhe plasaritje terthore horizontale.

*Keto demtime te permedura me siper ilustrohen ne fotot bashkangjitur ketij studimi.*

- **Perforcimi i struktures**

Struktura do te perforcohet duke nderhyre ne muret mbajtese me veshje me beton torcrete (me rezistence 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diameter 5 mm. Zgarat do te lidhen me shufra terthore dhe do te vendosen ne te dyja faqet e mureve.

Soletat do te perforcohen duke perdorur zgara te tipeve T 188 siper dhe T 92 poshte. Nga siper soletat do te vishen me beton C20/25 dhe nga poshte do te vishen me beton torcrete. Lidhja e te dyja shtresave do te behet me shufra terthore te cilat do te futen ne zonat e bashkimit te paneleve. Soletat gjithashtu do te lidhen me muraturen nepermjet shufrave te cilat do te inkastrohen ne faqen e jashtme te murit me ane te pllakave metalike.

*Per detajet e perforcimit referohuni projektit te perforcimit bashkangjitur ketij studimi.*


Per llogaritjet statike dhe dinamike te struktures se objekteve jane perdorur programet TEKLA STRUKTURAL DESIGNER 2019 dhe ETABS 2017. Struktura eshte modeluar ne 3D me ndihmen e programeve te avancuara kompjuterike duke perdorur elementet “Frame” (per traret dhe kollonat b/a), ato “Shell” (per soletat dhe shkallet b/a) dhe “Wall” (per muraturen). Per themelet eshte perdorur si

mbeshtetje koeficienti i Winklerit.


Të gjitha parametrat e përdorura në kontrollin e elementeve të strukture janë të përfshira në ("Eurocode"): projektimi strukturor është bazuar në kodet e mëposhtme:

- |     |             |                                                                                                                                                   |
|-----|-------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| [0] | EN 1990     | Eurocode 0 – Eurocode Basis of structural design                                                                                                  |
| [1] | EN 1991-1-1 | Eurocode 1 – Action on structures: General Action                                                                                                 |
| [2] | EN 1991-1-4 | Eurocode 1 – Action on structures: Wind Actions                                                                                                   |
| [2] | EN 1992-1-1 | Eurocode 2 – Design of concrete structures: General Rules                                                                                         |
| [4] | EN 1994-1-1 | Eurocode 2 – Design of composite steel and concrete structures: General Rules and rules for building                                              |
| [6] | EN 1996-1-1 | Eurocode 6 -- Design of masonry structures: General rules for reinforced and unreinforced masonry structures                                      |
| [8] | EN 1998-1-1 | Eurocode 8 – Design of structures for earthquake resistance                                                                                       |
| [9] | KTP-N.2-89  | Earthquake Resistant Design Regulations, issued by: Seismic Center, Academy of Science of Albania, Department of Design, Ministry of Construction |


- Plani i strukturave, kati nentoke




- Plani i strukturave, kati perdhe




- *Plani i strukturave, kati i pare*




- *Me poshte tregohen fragmente te modelimit te strukture ekzistuese per qelimet e keij studimi, me programet e avancuara kompjuterike ETABS 2017 dhe TSD 2019:*



- *Pamje 3D e strukture*




- Pamje 3D e struktures



- Pamje 3D e struktures





- Pamje 3D e struktures

Llogaritjet e kontrollit per efekt te ketij studimi, jane kryer me programet ETABS ULTIMATE 2017 dhe TEKLA STRUCTURAL DESIGNER. Ndertesa eshte modeluar duke u konceptuar si sistem me murature mbajtese. Modeli dinamik i zgjedhur eshte ai me masa dhe parametra te shperndara. Ngarkesat dhe kombinimi i tyre jane percaktuar sipas Eurocode 1, 2, 5, 8 dhe jane paraqitur ne menyre te permblendhur ne tabelen e meposhtme (ne modelet llogaritese jepen me hollesi ngarkesat, mbingarkesat dhe kombinimet e tyre). Ngarkesa nga pesha vetjake e elementeve strukturele beton arme llogariten automatikisht nga programi bazuar ne volumen e elementit si dhe peshen njesi te  $b/a$   $2500 \text{ kg/m}^3$  dhe  $1800 \text{ kg/m}^3$  per muraturen. Gjate llogaritjes se objektit per qellimet e ketij studimi jane marre parasysh ngarkesat dhe kombinimet e tyre si me poshte.

Ngarkesat dhe kombinimet e tyre jane konform KTP-N2-89 dhe Eurocode.

#### a. Ngarkesat Statike - (te Normuara) Ngarkesat e perhershme (Dead Loads-DL)

Ne ngarkesat e perhershme jane perfshire: Pesha vetjake e gjithë elementeve mbajtes te struktures prej murature dhe beton arme (themele, trare, kolona, mure, pesha vetjake e soletave, shtresave te dyshemese, muret ndares vetembajtes me tulla, dhe parapetet e ballkoneve, shkalleve etj). Ngarkesat e normuara qe jane marre ne considerate per strukturen e mesiperme jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

| DEAD LOADS                 |       |                   |                        |       |                   |
|----------------------------|-------|-------------------|------------------------|-------|-------------------|
| Concrete specific gravity: | 25.00 | kN/m3             | Slab coating:          | 1.50  | kN/m <sup>2</sup> |
| Steel specific weight:     | 78.00 | kN/m3             | Room tiling:           | 1.50  | kN/m <sup>2</sup> |
| Header wall weight:        | 3.60  | kN/m <sup>2</sup> | Staircase tiling:      | 1.30  | kN/m <sup>2</sup> |
| Stretcher wall weight:     | 2.10  | kN/m <sup>2</sup> | Soil specific gravity: | 18.00 | kN/m3             |

### 1) Te perhershme (te Normuara)

Pesha Vetjake e Soletes  $t = 25 \text{ cm}$

Pesha Vetjake e Soletes  $t = 12 \text{ cm}$

Shtresat si ngarkese siperfaqesore

Shtresat e taraces si ngarkese siperfaqesore

Muret si ngarkese siperfaqesore e shperndare

Ngarkesa nga tavanet e varura perfshire instalimet

Vetratat e xhamit (fasadat)

$g_{sol, 20 \text{ cm}} = 300 \text{ kg/m}^2$

$g_{sol, 15 \text{ cm}} = 300 \text{ kg/m}^2$

$g_{sht} = 150 \text{ kg/m}^2$

$g_{tar} = 200 \text{ kg/m}^2$

$g_m = 200 \text{ kg/m}^2$

$g_{tav} = 50 \text{ kg/m}^2$

$g_{xh} = 100 \text{ kg/m}^2$

### b. Ngarkesat Variable (te Normuara) Ngarkesat e perkohshme (Live Loads - LL)

Si ngarkesa te perkohshme ne strukture jane llogaritur ngarkesat e shfrytezimit te dysHEMEVE te banesave, nderkateve, shkalleve, taracave etj, te cilat ne menyre te permbledhur jane paraqitur gjithashtu ne tabelen e meposhtme:

| LIVE LOADS         |      |                   |                                   |      |                   |
|--------------------|------|-------------------|-----------------------------------|------|-------------------|
| Residences floors: | 2.00 | kN/m <sup>2</sup> | Offices floors:                   | 2.00 | kN/m <sup>2</sup> |
| Balconies floors:  | 5.00 | kN/m <sup>2</sup> | Staircases floors for residences: | 3.50 | kN/m <sup>2</sup> |

Ngarkesat e mesiperme jane nominale dhe varesi te kombinimit per te cilin do te kontrollohet struktura, ngarkesat e perhershme (DL) apo ato te perkohshme (LL) shumezohen me koeficientin perkates te sigurise.

### 2) Te perkohshme (te Normuara)

Ngarkesa e perkohshme per banim  $200 \text{ kg/m}^2$


Ngarkesa e perkohshme per taracen  $200 \text{ kg/m}^2$

Ngarkesa e perkohshme per shkallet dhe ambjente konsol  $500 \text{ kg/m}^2$

### b. Ngarkesat Sizmike

|                                   |                                                                 |
|-----------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| Sizmiciteti i Zones               | $I = 8.5$ balle (MSK-64, Harta e Mikrozonimit Sizmik te RSH)    |
| Kategoria e Truallit              | E Dyte - II (KTP-N2-89), C (EC8 2004)                           |
| Koeficienti i rendesise           | $k_r = 1.0$                                                     |
| Shpejtimi Sizmik                  | $a_g = 0.280$ (Studimi Inxhiniero-Sizmologjik)                  |
| Faktori i sjelljes                | $q = 1.5$ (i percaktuar teorikisht ne mbeshtetje me EC8 2005:3) |
| Koeficienti i shuarjes            | $\zeta = 5\%$                                                   |
